RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

PËR

AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

NË

AGJENCINË TELEGRAFIKE SHQIPTARE

Tiranë, korrik 2026

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 3
2. Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 4
3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit 5
II. HYRJA 6
1. Objektivat dhe qëllimi 6
2. Identifikimi i çështjes 6
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 6
4. Përgjegjësitë e audituesve 6
5. Kriteret e vlerësimit 7
6. Standardet e auditimit 7
7. Metodat e auditimit 7
8. Dokumentimi i auditimit 7
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 8
1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim 8
2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit 8
2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK 8
2.2 Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit 13
IV. REKOMANDIME 19

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, nga data 17.02.2026 deri në 31.03.2026.
Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme nga pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë, mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit. Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

a. *Përshkrim i shkurtër për subjektin në auditim*

Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATSH) është institucioni qendror kombëtar të informacionit në Republikën e Shqipërisë. Misioni parësor i agjencisë është grumbullimi, përpunimi dhe shpërndarja e lajmeve që pasqyrojnë zhvillimet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit. Si agjencia e vetme zyrtare e lajmeve, ATSH shërben si burimi kryesor dhe i certifikuar i informacionit për mediat vendase, agjencitë ndërkombëtare dhe trupin diplomatik të akreditуar në Shqipëri.
Në kuadër të shkëmbimit të informacionit dhe standardizimit profesional, ATSH është anëtare aktive e organizatave më prestigjioze të agjencive të lajmeve, si Aleanca Evropiane e Agjencive të Lajmeve (EANA) dhe Asociacioni i Agjencive të Lajmeve të Ballkanit dhe Evropës Juglindore (ABNA-SE). Përmes marrëveshjeve dypalëshe me agjenci si ANSA (Itali), AA (Turqi) dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë, institucioni siguron një prani të vazhdueshme të lajmit shqiptar në arenën globale. Transmetimi i lajmeve në gjuhët anglisht dhe frëngjisht mbetet një shtyllë strategjike për informimin e opinionit ndërkombëtar mbi realitetin në vend.
Në drejtim të teknologjisë së infromacionit agjencia nuk ka patur investime të qëndrueshme, që të ndihmojnë vijueshmërinë operacionale dhe mbrojtjen e aseteve të informacionit.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij

Rëndësia e këtij auditimi qëndron në faktin se Agjencia Telegrafike Shqiptare ka një rëndësi të veçantë si i vetmi institucion zyrtar kombëtar i lajmeve, roli i të cilit është grumbullimi, përpunimi dhe shpërndarja e informacionit të certifikuar për mediat vendase, agjencitë ndërkombëtare dhe trupin diplomatik të akreditуar në vend. Përveç funksionit informativ, institucioni administron Arkivën Fotodokumentare kombëtare, një fond prej mbi 500,000 negativësh dhe fotografish që përbën "kujtesën vizuale" të shtetit shqiptar. Institucioni nuk ka pasur investime të qëndrueshme në TI dhe operon mbi një bazë ligjore të vjetruar, çka e ekspozon institucionin.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i auditimit bazuar në programin e auditimit është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të, për periudhën 01.01.2023-31.12.2024.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Grupi i auditimit, në fazën e planifikimit, mblodhi informacion të përgjithshëm mbi subjektin nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave për identifikimin e zonave me risk të lartë, mbi bazën e të cilave u hartuan drejtimet e auditimit dhe kërkesat për informacion, në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Metodat dhe teknikat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave janë përdorur veçmas ose të kombinuara, duke përfshirë: shqyrtimin e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe të dokumenteve mbi përdorimin e sistemeve informatike; intervistat me personat përgjegjës; verifikimin teknik dhe analizimin e funksioneve të sistemit e të dhënave të eksportuara nga sistemet; si dhe rakordimin e

informacionit të marrë nga subjekti me të dhënat publike të faqes zyrtare dhe evidencat teknike. Të dhënat e grumbulluara u vlerësuan përballë kritereve ligjore, rregullative dhe standardeve ndërkombëtare (ISSAI 5300, ISSAI 5310, ISO/IEC 27001), me qëllim formimin e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve mbi bazën e një evidence të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme audituese.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga auditimi rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 9 gjetje dhe ka dhënë 9 rekomandime, nga të cilat 1 masë propozim për ndryshim apo përmirësim në legjislacionin në fuqi dhe 8 masa organizative me 8 gjetje dhe 8 rekomandime.

2. Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Telegrafike Shqiptare vijon të operojë me Dekretin nr. 1960, datë 09.11.1954 të kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Populllor, pa ndërmarrë, deri në momentin e auditimit, asnjë nismë zyrtare për rishikimin apo zëvendësimin e tij, që do të rregullonte funksionimin e institucionit në përputhje me standardet moderne të medias dhe sigurisë kibernetike. Ky akt normativ është i vjetruar dhe nuk pasqyron zhvillimet teknologjike apo kërkesat e kohës për një agjenci lajmesh në kohën digjitale. Operimi me një dekret të vitit 1954 e bën të pamundur zbatimin e kornizave moderne të qeverisjes TIK si ISO 27001 apo mbrojtjes së të dhënave, duke ekspozuar institucionin ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit.
- Nga auditimi në Agjencinë Telegrafike Shqiptare u konstatuan mangësi në kuadrin rregullator, procedurat e brendshme dhe infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit. Institucioni nuk dispononte procedura të plota dhe të miratuara për proceset kryesore të TIK-ut, përfshirë menaxhimin e incidenteve, monitorimin e performancës dhe administrimin e ciklit jetësor të aseteve teknologjike, duke krijuar paqartësi në përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive. Në aspektin teknik, infrastruktura e TIK-ut paraqitej me dobësi të konsiderueshme, të evidentuara nga mungesa e masave aktive të mbrojtjes, përdorimi i programeve pa licencim të rregullt dhe mungesa e mekanizmave të përshtatshëm për kontrollin e aksesit. Këto problematika shoqëroheshin edhe me mungesën e një planifikimi të strukturuar buxhetor për investime në teknologjinë e informacionit, duke kufizuar mundësinë për zhvillimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e qëndrueshme të kapaciteteve teknologjike. Mangësitë e mësipërme kufizojnë kapacitetet funksionale të ATSH-së dhe e ekspozojnë institucionin ndaj sulmeve kibernetike si dhe humbjeve apo manipulimit të të dhënave. Kjo situatë bie në kundërshtim me nenet 9 dhe 16 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar si dhe me standardet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Agjencia Telegrafike Shqiptare të iniciojë pranë Këshillit të Ministrave shfuqizimin e Dekretit nr. 1960, datë 09.11.1954 "*Mbi Agjencinë Telegrafike Shqiptare*", dhe të propozojë hartimin e një projektligji të ri për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë, që të jetë në harmoni me legjislacionin aktual për mediat, arkivat, si dhe mbrojtjen e të dhënave dhe sigurisë së informacionit.
- Agjencia Telegrafike Shqiptare të marrë masa për planifikimin dhe realizimin e investimeve të qëndrueshme për modernizimin e infrastrukturës IT, me qëllim rritjen e sigurisë, performancës dhe vazhdimësisë së shërbimeve, si dhe të hartojë dhe miratojë një bazë të plotë rregullatore në fushën e teknologjisë së informacionit, duke përcaktuar qartë politikat, procedurat, rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e proceseve IT, përfshirë menaxhimin e incidenteve, monitorimin e performancës dhe rinovimin e aseteve.

3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310), si dhe në nenet 3 dhe 14 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nga auditimi u konstatua se Agjencia Telegrafike Shqiptare operon mbi një bazë ligjore dhe rregullatore të vjetruar, e cila nuk mbështet zbatimin e praktikave dhe standardeve bashkëkohore të qeverisjes së teknologjisë së informacionit, përfshirë standardin ISO/IEC 27001 dhe kërkesat për mbrojtjen e të dhënave. Kjo mungesë e kornizave rregullatore, e shoqëruar me amortizimin e infrastrukturës dhe të protokolleve të sigurisë, rrit ekspozimin e institucionit ndaj risqeve kibernetike dhe cenon aftësinë për të garantuar vijueshmërinë dhe integritetin e shërbimeve. Mangësitë në planifikimin strategjik, mungesa e regjistrit të riskut dhe paqartësitë në ndarjen funksionale të detyrave reflektojnë dobësi në qeverisjen dhe menaxhimin e teknologjisë së informacionit.

Në këto kushte, vlerësohet se Agjencia Telegrafike Shqiptare ka nevojë për ndërmarrjen e një reforme të menjëhershme të kuadrit ligjor dhe rregullator, të shoqëruar me investime të dedikuara në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", në zbatim të programit nr. 1208/1 prot., datë 13.02.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 17.02.2026 deri më datë 31.03.2026, në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, u krye auditimi mbi teknologjinë e informacionit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. C., përgjegjëse grupi;
2. A. K., anëtare;
3. A. A., anëtar.

1. Objektivat dhe qëllimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në ATSH, nga data 17.02.2026 deri më datë 31.03.2026. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.
Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, mbrojnë asetet e informacionit; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe mbështeten në kontrolle të duhura.
Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

2. Identifikimi i çështjes

Fusha e audituar është teknologjia e informacionit dhe komunikimit, me fokus qeverisjen, sistemeve dhe sigurisë së sistemeve të informacionit të subjektit.
Agjencia Telegrafike Shqiptare, është institucioni qendror kombëtar i informacionit në Republikën e Shqipërisë, i cili funksionon në bazë të Dekretit nr. 1960, datë 09.11.1954 "*Mbi Agjencinë Telegrafike Shqiptare*".
Me programin nr. 1208/1 prot, me datë 13.02.2026, janë identifikuar drejtimet në vijim:
1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK;
2. Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Agjencia Telegrafike Shqiptare është zëri zyrtar i informimit publik në Republikën e Shqipërisë. Institucioni funksionon në bazë të Dekretit nr. 1960, datë 09.11.1954 "*Mbi Agjencinë Telegrafike Shqiptare*", dhe ka përgjegjësinë të sigurojë prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit zyrtar në mënyrë të saktë, të paanshme dhe në kohë reale.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi ATSH mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 deri në 31.12.2025, në drejtim të teknologjisë së informacionit, që është në përdorim dhe i shërben institucionit.
Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 1208/1 Prot., datë 13.02.2026 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI) si dhe legjislacionin e fushës në të cilën operon ATSH. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese

është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar marrjen e masave, për përmirësimin e situatës.
Kriteret ligjore, rregullative dhe standardet mbi të cilat është mbështetur auditimi, janë si më poshtë:

- Ligji nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Dekreti nr.1960, datë 09.11.1954 "*Mbi Agjencinë Telegrafike Shqiptare*";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr. 14/2023, datë 16.02.2023;
- Ligji nr. 119 datë 18.09.2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali i Auditimit IT si dhe Standardet Ndërkombëtare ISO27001, etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, ISO 27001, etj.

7. Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit;
- Shqyrtimi i dokumenteve rregullatorë mbi përdorimin e sistemeve informatike;
- Intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Analizimi i funksioneve të sistemit dhe të dhënave të eksportuara nga sistemi, etj.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATSH) është institucioni qendror kombëtar të informacionit në Republikën e Shqipërisë. Misioni parësor i agjencisë është grumbullimi, përpunimi dhe shpërndarja e lajmeve që pasqyrojnë zhvillimet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit. Si agjencia e vetme zyrtare e lajmeve, ATSH shërben si burimi kryesor dhe i certifikuar i informacionit për mediat vendase, agjencitë ndërkombëtare dhe trupin diplomatik të akreditуar në Shqipëri.
Institucioni mbart një peshë të rëndësishme në dokumentimin e historisë kombëtare përmes Arkivës së tij Fotodokumentare, e cila konsiderohet si "kujtesa vizuale" e shtetit shqiptar. Me një fond që tejkalon 500,000 negativë dhe fotografi që datojnë që nga fillimi i shekullit XX, ATSH administron një trashëgimi unike që pasqyron periudha të ndryshme historike. Vitet e fundit, agjencia ka prioritetizuar procesin e digjitalizimit dhe restaurimit të këtij fondi, duke synuar ruajtjen afatgjatë dhe rritjen e aksesueshmërisë së këtij aseti për qëllime kërkimore dhe editoriale.
Në kuadër të shkëmbimit të informacionit dhe standardizimit profesional, ATSH është anëtare aktive e organizatave më prestigjioze të agjencive të lajmeve, si Aleanca Evropiane e Agjencive të Lajmeve (EANA) dhe Asociacioni i Agjencive të Lajmeve të Ballkanit dhe Evropës Juglindore (ABNA-SE). Përmes marrëveshjeve dypalëshe me agjenci si ANSA (Itali), AA (Turqi) dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë, institucioni siguron një prani të vazhdueshme të lajmit shqiptar në arenën globale. Transmetimi i lajmeve në gjuhët anglisht dhe frëngjisht mbetet një shtyllë strategjike për informimin e opinionit ndërkombëtar mbi realitetin në vend.
Në mjedisin aktual mediatik, ATSH funksionon si garant i saktësisë dhe integritetit të informacionit. Institucioni zbaton protokolle strikte verifikimi, duke shërbyer si barrierë kundër përhapjes së lajmeve të rreme (fake news). Operacionet e saj shtrihen në monitorimin institucional, prodhimin e materialeve multimedia dhe raportimin në kohë reale, duke ruajtur rolin e saj si pikë referimi për vërtetësinë e informacionit zyrtar në Shqipëri.
Në drejtim të teknologjisë së infromacionit agjencia nuk ka patur investime të qëndrueshme, që të ndihmojnë vijueshmërinë operacionale dhe mbrojtjen e aseteve të informacionit.

2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

Në zbatim të pikës 1 "*Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK"*, u shqyrtua, si më poshtë:
- Dekreti nr.1960, datë 09.11.1954 "*Mbi Agjencinë Telegrafike Shqiptare*";
- Plani strategjik për vitin 2025, nr. 26 prot., datë 06.01.2025;
- Strategjia për menaxhimin e riskut të Teknologjisë së Informacionit të Agjencisë Telegrafike Shqiptare për vitin 2023;
- Rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Organigrama dhe struktura organizative e institucionit;
- Lista e punonjësve të IT sipas kategorisë, hierarkisë, pozicionit të punës në strukturë;
- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës, etj;

Strategjia në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit
Strategjia e TI përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektivave të Strategjisë së TI dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së TI duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të institucionit, kapacitetin aktual të TI për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së TI, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe

paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit.
Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Telegrafike Shqiptare ka miratuar një plan strategjik për vitin 2025 me nr. 26 prot., datë 06.01.2025 me objektiva të përcaktuara për këtë vit ku në lidhje me teknologjinë e informacionit si objektiva janë vendosur:

- Dokumentimi më cilësor i nevojave si për sistemet ekzistuese dhe për sistemet e reja të IT-së.

Për këtë objektiv nuk është bërë dokumentim i nevojave për sistemet ekzistuese apo për sisteme të reja. Masat e marra për realizimin e këtij objektivi janë fokusuar në krijimin e një albumi digjital për fotot dhe albumet e ATSH ndër vite, i cili nuk lidhet drejtpërdrejtë me përmbushjen e objektivit të përcaktuar. Ky sistem po zhvillohet si pjesë e një projekti në bashkëpunim me drejtorinë e përgjithshme të arkivave. Aktualisht ATSH është në fazën e kalimit të materialeve nga fizike në digjitale.

- Kërkesë për financimin e një sistemi rezervë (backup IT-së), plan rikuperimi nga difektet e testuara në praktikë. Për të shmangur një problematikë të tillë, që i gjithë informacioni i prodhuar në ATSH të ruhet në një rezervë.

Për këtë objektiv nuk është marrë asnjë masë dhe nuk ka asnjë kërkesë për një sistem rezervë, plan rikuperimi nga difektet e testuara në praktikë.
Nga auditimi u konstatua se, objektivat strategjike të institucionit në fushën e teknologjisë së informacionit nuk janë të përcaktuara në mënyrë të plotë dhe të qartë, si dhe nuk pasqyrojnë në mënyrë të mjaftueshme nevojat aktuale të institucionit në drejtim të infrastrukturës, sigurisë, kapaciteteve njerëzore dhe zhvillimit teknologjik.
Në planin strategjik të vitit 2025 është planifikuar dhe hartimi i një ligji specifik për Agjencinë Telegrafike Shqiptare duke qenë se nuk ka ende një ligj për funksionimin e saj dhe bazohet në Dekretin nr.1960, datë 09.11.1954 "*Mbi Agjencinë Telegrafike Shqiptare*".
Kuadri ligjor i vitit 1954 është tërësisht i vjetëruar dhe nuk adreson nevojat e qeverisjes TIK të një agjencie lajmesh moderne, duke krijuar një vakum rregullator për administrimin, ruajtjen dhe publikimin e përmbajtjes informative dhe fotografike të lajmeve.
Nga auditimi u konstatua se, në Agjencinë Telegrafike Shqiptare nuk ka ende asnjë draft dhe asnjë kërkesë zyrtare për hartimin e një ligji të ri në të cilin ky institucion të bazohet për funksionimin e tij.
Nëse vazhdohet me Dekretin e vitit 1954, institucioni nuk mund të aplikojë për fonde apo projekte të BE-së për digjitalizimin, pasi nuk ka një kornizë moderne qeverisëse.
Në mungesë të një akti të posaçëm ligjor i cili të përcaktojë qartë statusin, kompetencat dhe funksionimin e institucionit, vlerësohet e nevojshme ndërmarrja e hapave konkrete për hartimin dhe miratimin e një kuadri të ri rregullator ligjor, me qëllim garantimin e ligjshmërisë, qartësisë funksionale, përgjegjshmërisë institucionale dhe rritjen e eficiencës administrative.

Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK
Monitorimi dhe kontrolli i riskut është procesi i identifikimit, analizimit dhe planifikimit për zbulimin e rreziqeve të reja të identifikuara, monitorimit të rreziqeve të identifikuara më parë dhe vlerësimit të atyre ekzistuese për të verifikuar strategjitë e reagimit ndaj rreziqeve të planifikuara për efektivitetin e tyre.
Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion dokumenti "*Strategjia për menaxhimin e riskut të Teknologjisë së Informacionit të Agjencisë Telegrafike Shqiptare për vitin 2023*", i cili është një dokument i miratuar në vitin 2023 për të cilin nuk ka pasur rishikime dhe përditësime.
Strategjia e Riskut 2023 mbetet një dokument formal, për përputhshmërinë ligjore pa asnjë ndikim operacional, pasi nuk shoqërohet me një Regjistër Risku aktiv që identifikon kërcënimet specifike për një agjenci medie, si p.sh. rreziku i hakerimit të faqes, humbja e arkivës fotografike etj.

Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Telegrafike Shqiptare nuk ka hartuar dhe nuk disponon regjistër risku në asnjë formë. Gjatë periudhës së audituar nuk rezulton të jenë identifikuar, dokumentuar dhe vlerësuar risqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave institucionalë, përfshirë edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.
Mungesa e regjistrit të riskut tregon se procesi i menaxhimit të riskut nuk është ngritur dhe nuk funksionon në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Mungesa e regjistrit të riskut është në kundërshtim me:

- Nenin 11, pika 2, i cili përcakton detyrimin për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, si dhe për vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që rrezikojnë arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave përkatëse;
- Nenin 12, pika 3/d, që përcakton përgjegjësinë e drejtuesve për identifikimin, vlerësimin dhe administrimin e risqeve nëpërmjet krijimit të regjistrit të riskut;
- Nenet 19–21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr. 14/2023, datë 16.02.2023, të cilat sanksionojnë detyrimin për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut në njësitë publike;
- Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar;
- Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 "*Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve*";
- Udhëzimin nr. 16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të Menaxhimit të Risqeve në Njësitë Publike*", i cili përcakton detyrimin për organizimin dhe funksionimin efektiv të procesit të menaxhimit të risqeve.

Në përputhje me sa më sipër, ATSH duhej të kishte ngritur, dokumentuar dhe administruar regjistrin e riskut, si instrument bazë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Mungesa e një Regjistri Risku TIK dhe e një Plani për Vazhdimësinë e Institucionit, e vendos ATSH-në në pozita vulnerabël përballë sulmeve kibernetike, ku koha e rikuperimit mbetet e panjohur, duke rrezikuar misionin e institucionit si zëri zyrtar i shtetit në botë.

Procedurat dhe rregulloret në TIK


Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit, verifikoi rregulloret dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara, si dhe nga praktikat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.
Nga auditimi u konstatua se, Teknologjia e Informacionit në Agjencinë Telegrafike Shqiptare zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. ATSH nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë se informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikat më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion, rregulla mbi menaxhimin e incidenteve, procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre, politika për rinovimin e aseteve për të ruajtur efikasitetin operacional etj. Mungesa e bazës së brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell operimin mbi baza ngjarjeje, duke rritur riskun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave ku reagimi është i paidentifikuar, burimet njerëzore dhe përgjegjësitë të paalokuara, si dhe koha e përgjigjes e papërcaktuar.

Vlerësimi i Burimeve Njerëzore

Për kryerjen e funksioneve institucionale Agjencia Telegrafike Shqiptare ka një strukturë organizative të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 162, datë 05.10.2023 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Telegrafike Shqiptare"*, miratuar në ATSH me

nr.578 prot., datë 06.10.2023 e cila është e ndërtuar mbi bazën e dy Drejtorive dhe katër Sektorëve.

Diagrama nr.1: Organigrama e Agjencisë Telegrafike Shqiptare në lidhje me sektorin e Multimedias dhe Teknologjisë



Burimi: ATSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Agjencisë Telegrafike Shqiptare është gjithsej 40, me 2 vende vakante nga të cilët një pozicion i përket specialistit në Sektorin e Multimedias dhe Teknologjisë. Detyrat specifike dhe përshkrimet e punës së punonjësve janë pjesë përbërëse e Rregullores së Brendshme miratuar me Urdhër nr. 14, datë 11.01.2023 protokolluar me nr. 13/1 prot., datë 11.01.2023 *"Rregullore e Brendshme e Agjencisë Telegrafike Shqiptare".* Mungesa e plotësimit të vendeve vakante, si dhe mbështetja në një numër të kufizuar specialistësh ku vetëm një punonjës mbulon fushën e teknologjisë së informacionit i cili është edhe përgjegjësi i sektorit, krijon një risk operacional për vazhdimësinë e shërbimit mediatik zyrtar.

Tabela nr.1: Struktura e Agjencisë Telegrafike Shqiptare sipas pozicioneve që ka secili punonjës aktualisht

Nr.	**Pozicioni**	**Nr. i punonjësve**		
		Plan	Fakt	**Arsimimi**
Sektori i Multimedias dhe Teknologjisë				
1	Përgjegjës Sektori	1	1	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Master Shkencor në Sistemet e Informacionit në Biznes
2	Specialist	2	1	Administrim dhe Politika Sociale
3	Fotoreporter	2	2	Arsim i mesëm Mësuesi për Histori-Gjeografi
4	Përpunues dhe Transmetues Fotosh	1	1	Komunikim Dizajn
Totali		**6**	**5**	

Burimi: ATSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi u konstatua se, për sektorin e Multimedias dhe Teknologjisë detyrat janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, ku ky sektor referohet si "*Sektori i Teknologjisë së Informacionit & Multimedias*". Këto përcaktime bazohen në Urdhrin e Kryeministrit nr. 135, datë 23.11.2021 i cili është i shfuqizuar, kjo krijon paqartësi në organizimin dhe funksionimin aktual të institucionit. Gjithashtu, detyrat për pozicionet e fotoreporterit, përpunuesit dhe

transmetuesit e fotove janë të përfshira në sektor të tjerë, duke reflektuar mungesë të një ndarje të qartë funksionale.

Trajnimet

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë.

Nga auditimi nuk u administruan dokumentacione mbi propozimet përkatëse, për zhvillimin e trajnimeve specifike. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim. Duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet dhe teknologjinë e informacionit.


Në sektorin e Multimedias dhe Teknologjisë vetëm njëri nga punonjësit e IT ka zhvilluar disa trajnime mbi sigurinë dhe Teknologjinë e Informacionit nga AKSK për vitin 2024 për të cilat është pajisur dhe me certifikat, por këto nuk janë të mjaftueshme për specialistët e teknologjisë së informacionit duke pasur parasysh që mbulojnë sistemin e publikimit të lajmeve dhe sistemin e publikimit të fotove për partnerët dhe duhet të zhvillojnë trajnime të herë pas hershme edhe për faqet web që kanë në përdorim. Duke qenë se siguria në këtë institucion është minimale dhe teknologjia ecën me ritme të shpejta në përmirësimin dhe avancimin e saj atëherë edhe trajnimet për punonjësit e IT dhe stafn që përdor pajisjet dhe faqen web për publikimin e lajmeve dhe fotove duhet të jenë të herë pas hershme.

Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Telegrafike Shqiptare për periudhën objekt auditimi 2024-2025, nuk ka pasur plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të cilët mbulojnë fushën e teknologjisë së informacionit si dhe punonjës të cilët janë përdorues të pajisjeve dhe faqes web për publikimin e lajmeve dhe fotove.

Transparenca e veprimtarisë së ATSH-së

Funksionimi i ATSH-së duhet të jetë transparent, gjithashtu, në shërbim të publikut. Në zbatim të Ligjit nr. 119 datë 18.09.2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar ka dalë Urdhri nr. 424 prot., datë 06.07.2022 "*Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar të Agjencisë Telegrafike Shqiptare*". Ky program është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të ATSH-së, www.ata.gov.al në menun "*Programi i Transparencës*".

Figura nr. 1: Programi i Transparencës së ATSH-së



Burimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare

Nga auditimi u konstatua se, dokumentet e publikuara në faqen web për programin e transparences së ATSH-së, konstatohet se një pjesë e tyre shkarkohen automatikisht në një dokument word dhe disa materiale janë bosh pa asnjë të dhënë, në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr.119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar, ku përcaktohet detyrimi i institucioneve publike për publikimin e informacionit të plotë, të saktë dhe të përditësuar për publikun.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur komente mbi rekomandimet e përcjella me Projektraportin me shkresën nr. 1208/3 Prot, datë 08.06.2026.

2.2 Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit

Në zbatim të pikës 2 "*Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit"*, u shqyrtua, si më poshtë:

- Infrastruktura e ndërtuar Hardware/ Software/ Network në ATSH;
- Menaxhimi i ndryshimeve dhe operacioneve TI;
- Siguria fizike e infrastrukturës TIK dhe procese të automatizuara;
- Web, Sistemi i publikimit të lajmeve dhe fotove për partnerët.

Infrastruktura TIK e ATSH-së

Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Agjencinë Telegrafike Shqiptare përbëhet nga tre komponentë kryesorë: hardware, software dhe rrjeti.

- **Hardware**
  - Server i dedikuar për ruajtjen e fotove (file share)
  - Kompjuter për gazetarët dhe administratën
  - Pajisje rrjeti (switch-e, router-e)
- **Software**
  - Sisteme operative: Windows 11, Windows 10 dhe Windows 7
  - Aplikacione për menaxhimin e lajmeve (WordPress)
- **Rrjeti**
  - Rrjeti lokal i ndarë sipas nevojave të departamenteve
  - VLAN-e të dedikuara për stacionet e punës dhe serverin
  - Akses për sistemet e menaxhuara nga palë të treta përmes VPN
  - Komunikim i brendshëm i siguruar përmes rrjetit local

Nga auditimi i infrastrukturës TIK dhe Sigurisë së Informacionit në Agjencinë Telegrafike Shqiptare u konstatua se:

- Infrastruktura aktuale IT e ATSH paraqitet në një nivel bazik dhe nuk përfshin një server qendror të konfiguruar me Domain Controller për menaxhimin e qendërzuar të përdoruesve dhe zbatimin e politikave të sigurisë. Mungesa e këtij komponenti kritik rrit ndjeshëm ekspozimin ndaj rreziqeve kibernetike, pasi kontrolli i aksesit dhe monitorimi i aktiviteteve janë të kufizuara. Në këtë kontekst, një incident i thjeshtë si klikimi i një linku keqdashës nga një përdorues (p.sh. gazetar) mund të çojë në kompromet imin e burimeve të përbashkëta, përfshirë serverin e dedikuar për ruajtjen e materialeve multimediale (share folder), duke mundësuar përhapjen e malware-it ose sulmeve phishing dhe duke rrezikuar integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e të dhënave. Gjithashtu, nuk disponon një firewall të dedikuar për mbrojtjen e rrjetit; kontrollet e sigurisë mbështeten në funksionalitetet e integruara të router-it Mikrotik, të cilat mund të jenë të kufizuara krahasuar me një zgjidhje të specializuar.

Nga auditimi u konstatua se, ATSH disponon në total 29 pajisje kompjuterike, nga të cilat 18 operojnë me Windows 11, 4 me Windows 10 dhe 7 me Windows 7, ku këto të fundit rezultojnë jashtë mbështetjes nga prodhuesi. Gjithashtu, u evidentua se në asnjë prej pajisjeve nuk është instaluar program antivirus, ndërsa pajisjet periferike (si printerët) janë kryesisht të vjetra dhe të amortizuara. Në 7 kompjuterë nuk është teknikisht i mundur përditësimi në Windows 11 për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme, ndërkohë që në të gjitha pajisjet paketa Office rezulton e pa licencuar.
Nga auditimi u konstatua gjithashtu se përdoruesit aksesojnë pajisjet me të drejta të kufizuara si përdorues lokalë, për të kryer instalime të ndryshme. Në lidhje me licencimin dhe përditësimin e sistemeve, rezulton se institucioni është njoftuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me shkresën nr. 1828 prot, datë 28.04.2025, për nevojën e përditësimit të sistemeve operative jashtë suportit teknik. Nga auditimi rezulton se nuk janë marrë masa konkrete në këtë drejtim pasi në buxhetin e vitit 2025 nuk janë parashikuar fonde për investime në teknologjinë e informacionit, ndërsa për vitin 2026 janë planifikuar vetëm blerja e një serveri dhe një pajisjeje kompjuterike për montazh, çka konsiderohet e pamjaftueshme në raport me problematikat e konstatuara.

Për sa më sipër, situata tregon se ATSH operon me mungesë të planifikimit të mjaftueshëm strategjik dhe buxhetor për përmirësimin e infrastrukturës IT dhe pa masa bazë sigurie, çfarë e ekspozon institucionin ndaj rreziqeve të ndryshme të humbjes, rrjedhjes apo ndryshimit të të dhënave.

Faqja zyrtare e internetit për publikimin e lajmeve dhe fotove për partnerët

Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATSH) ka ngritur një platformë në WordPress për publikimin e lajmeve dhe shpërndarjen e fotove për partnerët e saj. Ky website është projektuar për të siguruar:

- Efikasitet editorial, duke lehtësuar procesin e krijimit, rishikimit dhe miratimit të përmbajtjes.
- Siguri dhe kontroll, përmes roleve të përcaktuara dhe aksesit të kufizuar në panelin administrativ.
- Shpërndarje të gjerë, duke mundësuar publikimin e përmbajtjes në portalin kryesor, në rrjete sociale dhe përmes feed-eve publike (RSS, API).

Procesi editorial përfshin disa faza: krijimi i artikujve nga gazetarët, rishikimi nga redaktorët, miratimi sipas hierarkisë së roleve dhe publikimi final. Administrimi i faqes web është i monitoruar në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar integritetin e të dhënave dhe funksionimin pa ndërprerje.

Faqja e ATSH (media.ata.gov.al) ofrohet me kontratë shërbimi ,objekti kontratës është ofrimi i shërbimit të hostimit të publikimit të fotove për partnerët,me afat 1(një) vjecar nënshkruar në datë 22.07.2025. Faqja është hostuar në një server cloud me SSD, duke përdorur WordPress si CMS. Siguria garantohet përmes SSL, firewall dhe backup-eve të rregullta. Parametrat teknikë përfshijnë optimizim të bazës së të dhënave, kompresim të imazheve dhe integrim për shpërndarje automatike në rrjete sociale dhe aplikacione mobile

Parametrat teknikë:


Serveri kryesor

- *Procesor:* CPU me benchmark rating minimumi 20,000
- *Memorie:* 64 GB DDR4 RAM
- *Storage:* 2 × 1 TB NVMe SSD (total 2 TB, konfigurim RAID 1)
- *Rrjet:* Portë 1 Gbit/s me trafik të pakufizuar

Backup


- Hard drive 1 TB
- I pavarur nga serveri primar, për të garantuar rikuperimin e të dhënave në rast avarie Media.ata.gov.al
- Host me menaxhim përmes cPanel për serverat DNS backup
- Kapacitet: 500 GB

Fig.1: Pamje e ndërfaqes së përdoruesit në sistemin e publikimit të fotove për partnerët



Burimi:Agjencia Telegrafike Shqiptare

Fig. 2: Ndërfaqja e përdoruesit të publikimit të fotove për partnerët



Burimi:Agjencia Telegrafike Shqiptare

Të dhënat INPUT përfaqësojnë informacionin bazë që futet, ngarkohet ose gjenerohet për t'u përpunuar më tej nga sistemi. Ato janë elementët themelorë mbi të cilët ndërtohet përmbajtja e publikuar.

– *Përmbajtje editoriale:* artikuj të shkruar nga gazetarët, tituj kryesorë dhe nën-tituj, përshkrime të shkurtra, etiketa për kategorizim. Këto janë bërthama e informacionit që do të publikohet.
– *Multimedia:* materiale vizuale dhe audio si foto, video, infografika dhe podcaste. Ato e pasurojnë përmbajtjen editoriale dhe e bëjnë më tërheqëse për publikun.
– *Metadata:* të dhëna ndihmëse si kategoria e lajmit, data e publikimit, autori, fjalët kyçe dhe burimi i informacionit. Metadata siguron renditje, kërkim dhe indeksim më të lehtë.
– *Të dhëna nga gazetarë/redaktorë:* komente editoriale, korrigjime, versione draft dhe shënime të brendshme. Këto ndihmojnë në procesin e rishikimit dhe miratimit.

- *Të dhëna teknike:* logje të sistemit, konfigurime, parametra të CMS-it dhe elementë të tjerë teknikë që garantojnë funksionimin e platformës.

Avantazhet e web-it editorial:

1. Automatizim i procesit editorial
- Redukton kohën e publikimit: artikujt kalojnë më shpejt nga drafti në publikim falë funksioneve automatike të CMS.
- *Rrit saktësinë:* minimizohen gabimet njerëzore përmes validimeve automatike (kontroll i metadata, formateve, kategorive).
- Proces i standardizuar*:* çdo artikull ndjek të njëjtin rrjedhë, duke siguruar cilësi të qëndrueshme.

2. Shkallëzim i lehtë
- Përshtatje për rritje trafiku*:* sistemi mund të menaxhojë më shumë vizitorë pa ndërprerje.
- Volum i lartë përmbajtjeje: lejon publikimin e dhjetëra artikujve në ditë pa ngarkesë shtesë për redaksinë.
- Fleksibilitet: mund të integrojë module të reja sipas nevojave (p.sh. seksione të reja tematike).

3. Siguri e lartë
- Backup i pavarur: ruajtje automatike e të dhënave për të shmangur humbjen e përmbajtjes.
- Monitorim i vazhdueshëm: gjurmim i logjeve dhe alarme për anomalitë teknike.
- Kontroll i aksesit: nivele të ndryshme autorizimi për gazetarë, redaktorë dhe administratorë.

4. Integrim me platforma të tjera
- Shpërndarje automatike në rrjete sociale: artikujt publikohen menjëherë edhe në Facebook, Instagram, Twitter/X.
- API për aplikacione mobile: përmbajtja e portalit konsumohet lehtësisht në aplikacione të palëve të treta.
- Ekosistem i hapur: lejon lidhje me sisteme analitike, reklama dhe platforma marketingu.

5. Transparencë dhe raportim
- Statistika të detajuara: vizita, lexime, ndërveprime, kohë mesatare e leximit.
- Raporte operative: pasqyrojnë performancën e redaksisë dhe të sistemit teknik.
- Vendimmarrje e bazuar në të dhëna: redaksia dhe menaxhimi marrin vendime strategjike mbi bazën e analizave reale.

OUTPUT-et në web editorial janë të dhëna të përpunuara që spublikohen pas procesimit të INPUT-eve.

1. Lajme të publikuara në portal (tekst + multimedia)
- Artikujt përfundimtarë me tituj, nën-tituj, përshkrime dhe elementë vizualë.
- Kombinimi i tekstit me foto, video dhe infografika e bën përmbajtjen më tërheqëse dhe më të kuptueshme.
- Ky është produkti kryesor që konsumon publiku.

2. Faqe kategorish dhe arkiva lajmesh
- Organizojnë përmbajtjen sipas temave (politikë, sport, kulturë, ekonomi, etj.).
- Arkivat ruajnë historikun e publikimeve, duke lejuar kërkime dhe referenca të mëvonshme.
- Sigurojnë transparencë dhe akses të lehtë në informacionin e kaluar.

3. Feed-e publike (RSS, API për app-in)
- Mundësojnë shpërndarjen automatike të përmbajtjes në platforma të tjera.
- API-të lejojnë integrim me aplikacione mobile ose sisteme të palëve të treta.
- Krijojnë një ekosistem ku përmbajtja e portalit mund të konsumohet në formate të ndryshme.

4. Njoftime dhe newsletter-e
- Kanale komunikimi direkte me audiencën.
- Përdoren për të rritur angazhimin dhe për të informuar lexuesit mbi përmbajtje të reja.
- Mund të personalizohen sipas interesave të lexuesve.

5. Statistika dhe raporte (vizita, lexime, ndërveprime)
- Japin pasqyrë mbi performancën e përmbajtjes.
- Ndihmojnë redaksinë të kuptojë çfarë pëlqehet më shumë dhe ku duhet përmirësim.
- Shërbejnë si bazë për vendimmarrje strategjike dhe optimizim editorial.

6. Përmbajtje e shpërndarë në rrjete sociale
- Rrit shtrirjen e lajmit përtej portalit.
- Gjeneron ndërveprime (komente, shpërndarje, pëlqime) që kthehen në feedback për redaksinë.
- Ndihmon në ndërtimin e komunitetit rreth markës mediatike.

7. Raporte operative për menaxhimin editorial dhe teknik
- Përfshijnë të dhëna mbi procesin e publikimit, performancën e sistemit dhe menaxhimin e burimeve.
- Ndihmojnë në vendimmarrje strategjike dhe optimizim teknik.
- Sigurojnë që sistemi të funksionojë në mënyrë efikase dhe pa ndërprerje.

Nga auditimi i faqes zyrtare të internetit

Administratorët e sistemeve, që janë specialisti i IT-së, si dhe 1 përfaqësues i kompanisë që ofron hostimin dhe mirëmbajtjen, kanë rol kyç në menaxhimin e infrastrukturës teknike të faqes. Ata janë përgjegjës për: menaxhimin e përdoruesve dhe roleve, kryerjen e backup-eve dhe rikuperimin e të dhënave.

Nga auditimi u konstatua se në sistemin WordPress të përdorur nga ATSH, llogaritë e përdoruesve të krijuara nga suporti teknik nuk detyrojnë ndryshimin e fjalëkalimit në hyrjen e parë (*first log-in*). Gjithashtu, në sistem nuk është implementuar autentifikimi me dy faktorë **(**2FA) për përdoruesit, ndonëse sipas praktikave të sigurisë së informacionit dhe standardeve ndërkombëtare ISO/ 27001 ku institucionet duhet të sigurojnë përdorimin e 2FA, veçanërisht për llogaritë me privilegje të larta.

Mungesa e këtyre kontrolleve rrit ndjeshëm rrezikun e kompromet imit të llogarive përmes sulmeve brute force ose phishing, aksesit të paautorizuar në panelin administrativ me impakt në reputacionin institucional.

Backup-et e faqes zyrtare të internetit media.ata.gov.al realizohen nga operatori, në përputhje me objektin e kontratës. Kontrata, e nënshkruar më 22.07.2025 me afat njëvjeçar, ka si objekt ofrimin e shërbimit të hostimit dhe publikimit të fotove për partnerët, siç përcaktohet në nenin 2, ku parashikohet edhe ofrimi i shërbimit të automatizuar të backup-it.

Nga auditimi u konstatua mungesa e një rregulloreje administrative të formalizuar për menaxhimin e procesit, si dhe moskryerja e testimeve periodike të rikuperimit të të dhënave. Kjo situatë krijon pasiguri mbi kohën e rikthimit të sistemit në funksion në rast problemi, duke e bërë atë të paparashikueshme.

Analiza e sigurisë së faqes zyrtare të internetit ata.gov.al

Për vlerësimin e konfigurimit SSL/TLS të serverit u përdor platforma SSL Labs, e cila shërben për të analizuar protokollet e komunikimit, certifikatat dhe parametrat e përgjithshëm të sigurisë. SSL Labs është e njohur kryesisht për testin publik SSL/TLS Server Test, ku çdo faqe web mund të kontrollohet dhe të marrë një vlerësim nga A+ deri në F, bazuar në cilësinë e konfigurimit të saj të sigurisë. Në këtë kontekst, analiza e kryer për faqen ata.gov.al ka dhënë një pasqyrë të plotë mbi gjendjen e saj aktuale të sigurisë. Serveri ende përdor protokollet e vjetra TLS 1.0 dhe TLS 1.1, të cilat nuk konsiderohen të sigurta sipas praktikave më të mira. Për shkak të kësaj, vlerësimi i sigurisë është kufizuar në vlerësim B, duke treguar se faqja

është e mbrojtur, por nuk arrin nivelin më të lartë të sigurisë. Përmirësimi i konfigurimit do të mundësonte një vlerësim më të lartë dhe mbrojtje më të fortë për përdoruesit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur komente mbi rekomandimet e përcjella me Projektaportin me shkresën nr. 1208/3 Prot, datë 08.06.2026.

IV. REKOMANDIME

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. **Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Telegrafike Shqiptare vijon të operojë me Dekretin nr. 1960, datë 09.11.1954 të kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, pa ndërmarrë, deri në momentin e auditimit, asnjë nismë zyrtare për rishikimin apo zëvendësimin e tij, që do të rregullonte funksionimin e institucionit në përputhje me standardet moderne të medias dhe sigurisë kibernetike. Ky akt normativ është i vjetruar dhe nuk pasqyron zhvillimet teknologjike apo kërkesat e kohës për një agjenci lajmesh në kohën digjitale. Operimi me një dekret të vitit 1954 e bën të pamundur zbatimin e kornizave moderne të qeverisjes TIK si ISO 27001 apo mbrojtjes së të dhënave, duke ekspozuar institucionin ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare të iniciojë pranë Këshillit të Ministrave shfuqizimin e Dekretit nr. 1960, datë 09.11.1954 "*Mbi Agjencinë Telegrafike Shqiptare*", dhe të propozojë hartimin e një projektligji të ri për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë, që të jetë në harmoni me legjislacionin aktual për mediat, arkivat, si dhe mbrojtjen e të dhënave dhe sigurisë së informacionit.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në drejtim të teknologjisë së informacionit nuk janë përcaktuar në mënyrë të plotë dhe të qartë objektivat strategjike të institucionit, si dhe nevojat aktuale të institucionit në drejtim të infrastrukturës, sigurisë, kapaciteteve njerëzore dhe zhvillimit teknologjik. Kjo situatë sjell rrezik për planifikim joefektiv dhe zhvillim të fragmentuar të sistemeve të teknologjisë së informacionit, veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, si dhe me praktikat e mira të menaxhimit dhe qeverisjes së teknologjisë së informacionit, të përcaktuara në kuadrin COBIT Framework.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare të marrë masa për të rishikuar dhe plotësuar Planin Strategjik në drejtim të TI-së, duke specifikuar objektiva të matshëm dhe të qartë që reflektojnë nevojat reale për modernizimin e infrastrukturës, forcimin e sigurisë kibernetike, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe inovacionin teknologjik dhe afate specifike për monitorimin e zbatimit të tyre.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se detyrat për sektorin e Multimedias dhe Teknologjisë janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme, të cilat bazohen në Urdhrin e Kryeministrit nr. 135, datë 23.11.2021 "*Për disa ndryshime në urdhrin nr. 95, datë 29.05.2019" të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Telegrafike Shqiptare*", i cili rezultoi i shfuqizuar. Gjithashtu, detyrat për pozicionet e fotoreporterit, përpunuesit dhe transmetuesit e fotove janë të shpërndara në sektorë të tjerë, duke reflektuar mungesë të një ndarje të qartë funksionale dhe duke krijuar paqartësi në organizimin dhe funksionimin aktual të institucionit. Rregullorja e Brendshme nuk është përditësuar në përputhje me strukturën aktuale dhe aktet rregullative në fuqi, duke mos

garantuar një përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësive, në kundërshtim me kërkesat e neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1 Rekomandimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare të marrë masa për rishikimin dhe përditësimin e Rregullores së Brendshme dhe përshkrimeve të punës për Sektorin e Multimedias dhe Teknologjisë, duke përcaktuar qartë ndarjen funksionale të detyrave dhe përgjegjësive për pozicionet e fotoreporterit, përpunuesit dhe transmetuesit të fotove, me qëllim shmangien e mbivendosjes së funksioneve ndërmjet sektorëve dhe garantimin e një organizimi efektiv operacional.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Telegrafike Shqiptare nuk ka hartuar dhe nuk disponon regjistër risku. Gjatë periudhës së audituar nuk rezulton të jenë identifikuar, dokumentuar dhe vlerësuar risqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar. Mungesa e një procesi të formalizuar të menaxhimit të riskut rrit ekspozimin e institucionit ndaj risqeve të sigurisë së informacionit dhe sulmeve kibernetike, duke krijuar paqartësi lidhur me masat parandaluese dhe kohën e rikuperimit në rast incidentesh, me ndikim potencial në vijueshmërinë e funksioneve institucionale, si transmetues zyrtar i informacionit të vendit në arenën ndërkombëtare.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1 Rekomandimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare të marrë masa për hartimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, ndjekjen dhe adresimin tek personat përgjegjës, duke përfshirë elemente të Teknologjisë së Informacionit, që ndikojnë në përmbushjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Telegrafike Shqiptare për vitet 2024-2025, nuk ka plan trajnimi vjetor për punonjësit të cilët kryejnë detyra funksionale në teknologjinë e informacionit, si dhe punonjës të cilët janë përdorues të faqes zyrtare të internetit për publikimin e lajmeve dhe fotove, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, si dhe standardet ndërkombëtare të TI për rritjen e kapaciteteve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1 Rekomandimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnim dhe hartimin e një programi të dedikuar për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore që mbulojnë fushën e Teknologjisë së Informacionit. Gjithashtu, të organizohen trajnime periodike për të gjithë punonjësit e institucionit mbi përdorimin e sigurt të teknologjisë së informacionit, mbrojtjen e të dhënave, si dhe të drejtat dhe detyrimet lidhur me përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve teknologjike në dispozicion të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, dokumentet e publikuara në faqen web në lidhje me programin e transparencës së ATSH-së, u konstatua se një pjesë e tyre shkarkohen automatikisht në një dokument word dhe disa materiale janë bosh pa asnjë të dhënë, në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar, ku përcaktohet detyrimi i institucioneve publike për publikimin e informacionit të plotë, të saktë dhe të përditësuar për publikun.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare të marrë masa për përditësimin e rubrikës së Programit të Transparencës në faqen zyrtare të internetit, duke siguruar që të gjitha të jenë të aksesueshme në formate lehtësisht të lexueshme, të plotësuara me informacionin përkatës, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për informim të plotë, të saktë dhe në kohë të publikut.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Agjencinë Telegrafike Shqiptare u konstatuan mangësi në kuadrin rregullator, procedurat e brendshme dhe infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit. Institucioni nuk dispononte procedura të plota dhe të miratuara për proceset kryesore të TIK-ut, përfshirë menaxhimin e incidenteve, monitorimin e performancës dhe administrimin e ciklit jetësor të aseteve teknologjike, duke krijuar paqartësi në përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive. Në aspektin teknik, infrastruktura e TIK-ut paraqitej me dobësi të konsiderueshme, të evidentuara nga mungesa e masave aktive të mbrojtjes, përdorimi i programeve pa licencim të rregullt dhe mungesa e mekanizmave të përshtatshëm për kontrollin e aksesit. Këto problematika shoqëroheshin edhe me mungesën e një planifikimi të strukturuar buxhetor për investime në teknologjinë e informacionit, duke kufizuar mundësinë për zhvillimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e qëndrueshme të kapaciteteve teknologjike. Mangësitë e mësipërme kufizojnë kapacitetet funksionale të ATSH-së dhe e ekspozojnë institucionin ndaj sulmeve kibernetike si dhe humbjeve apo manipulimit të të dhënave. Kjo situatë bie në kundërshtim me nenet 9 dhe 16 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar si dhe me standardet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13- 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
6.1 Rekomandimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare të marrë masa për planifikimin dhe realizimin e investimeve të qëndrueshme për modernizimin e infrastrukturës IT, me qëllim rritjen e sigurisë, performancës dhe vazhdimësisë së shërbimeve, si dhe të hartojë dhe miratojë një bazë të plotë rregullatore në fushën e teknologjisë së informacionit, duke përcaktuar qartë politikat, procedurat, rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e proceseve IT, përfshirë menaxhimin e incidenteve, monitorimin e performancës dhe rinovimin e aseteve.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, u konstatuan mangësi në menaxhimin e aksesit dhe sigurinë e llogarive të përdoruesve. Konkretisht, llogaritë e krijuara nga suporti teknik nuk ishin të konfiguruara për të kërkuar ndryshimin e detyrueshëm të fjalëkalimit në hyrjen e parë (first log-in). Për më tepër, sistemi nuk kishte të implementuar identifikimin me dy faktorë (2FA), në kundërshtim me standardin ISO/IEC 27001 dhe praktikat më të mira të sigurisë së informacionit, të cilat kërkojnë zbatim të masave të sigurisë veçanërisht për llogaritë me shumë privilegje.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
7.1 Rekomandimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare të marrë masa për zbatimin e mekanizmave të sigurisë në sistemin WordPress, duke garantuar ndryshimin e fjalëkalimit në hyrjen e parë dhe aktivizimin e autentifikimit me dy faktorë (2FA),, veçanërisht për llogaritë me shumë privilegje, në përputhje me standardet e sigurisë së informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sigurisë së serverit u konstatua se infrastruktura vijon të përdorë protokollet e vjetra TLS 1.0 dhe TLS 1.1, të cilat nuk konsiderohen të sigurta sipas praktikave më të mira të sigurisë së informacionit. Ky konfigurim ndikonte në nivelin e sigurisë së sistemit, i cili ishte vlerësuar me notën "B", duke reflektuar një nivel bazë mbrojtjeje, por jo në përputhje me kërkesat optimale të sigurisë dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit, përfshirë ISO/IEC 27001 dhe udhëzimet teknike përkatëse.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
8.1 Rekomandimi: Agjencia Telegrafike Shqiptare të marrë masa për përditësimin e konfigurimit të serverit duke çaktivizuar protokollet e vjetra TLS 1.0 dhe TLS 1.1 dhe duke implementuar versione më të sigurta (si TLS 1.2 dhe/ose TLS 1.3), në mënyrë që të rrisë nivelin e sigurisë, të përmirësojë vlerësimin e sigurisë dhe të garantojë mbrojtje më të fortë për përdoruesit.

Menjëherë

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT